

Komunikatë

Prishtinë, 31 Tetor 2018

Fillon Gara Robotike "KOSOVA MAKERS LEAGUE" (KML)



Te shtunen me 03.11 Projekti "KOSOVA MAKERS LEAGUE" (KML) fillon Raundin e Pare te Liges Robotike. "KML Open - Raundi i Pare" do te zhvillohet ne pese komuna: Prishtine, Gjakove, Mitrovice, Shtime, dhe Kacanik ku do te takohen mbi 120 ekipe shkollore nga i gjithë vendi. Projekti KML implementohet nga Fondacioni BONEVET dhe mbështetet nga nje koalicion i gjere i partnereve nga sektori publik: "Fondacioni Une e Du Kosoven" "Agjencioni Zviceran per Zhvillim dhe Bashkepunim", "Agjencioni Gjerman per Zhvillim dhe Bashkepunim", "American Advising Center" dhe nga sektori privat: "Raiffeisen Bank Kosovo", "Ipko", "Auto Mita", "Korporata Rugova", dhe "Trosha".

Nëpërmjet qëllimit "një robot për cdo fëmijë" synojmë të përmbushim misionin e projektit që është "inspirimi i liderëve të ardhshëm në fushën e shkencës dhe teknologjisë". Deri tash projekti ka dhuruar 650 robote mBot që mundëson zhvillimin e avancuar të STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë) në sistemin tonë arsimor. Projekti "Kosova Makers League" jo vetëm që sjelle garën nacionale të robotikes për të gjitha shkollat e nivelit të përgjithshëm arsimor, por edhe i mbështet të gjitha shkollat pjesëmarrëse me robote dhe aspekte tjera në vlerë prej 600 EUR. Rrjedhimisht nxenesit do të përfitojnë mundësi të praktikës me pajisjet me të fundit të rekomanduara për të hyrë në fushën e robotikes dhe programimit. Për më tepër, KML është një prej programeve më shpërblyese në Kosovë për të rinj si në aspekt të zhvillimit personal si në aspektin e krijimit të një ambienti të shëndoshe për socializim edhe rrjetëzim të bashkëmoshatareve të prirur dhe që kanë pasion shkencën dhe teknologjinë.

Gjate vitit shkollor do të jenë pese raunde ku shkollat pjesëmarrëse do të garojnë për cmime të



cilat jane mundesi arsimore shtese si kurse profesionale ne Fondacioin BONEVET, dhurata teknologjike, libra, dhe cmimet kryesore: udhetime ne Zagreb te Kroacise per te marre pjese ne Garen Rajonale te Robotit Arsimor dhe mundesia per t'u kualifikuar ne Garen Boterore ne Shangaj te Kines.

Me 3 nentor, ju ftojme te percjellni nga afer ngjarjet e Liges Robotike KML ne pese qendra rajonale. Detajet vijojne me poshte. Vini re se projekti eshte sensitiv pasi qe punohet me nxenes te nivelit te ulte nga klasa e pare deri te klasa e nente. Cdo femiu duhet te ju respektohet e drejta e privatesise prandaj ndalohet cdo forme e ekspozimit pa leje te maparshme te stafit menaxhues te projektit. **Cdo medie e interesuar te ndjeke ngjarjen duhet** te paralajmroj ardhjen duke specifikuar cilat pika nga 5 qendrat rajonale do te vizitohen edhe kohen kur do vije ekipa juaj. Per cdo kerkese dhe informacion deri ne ditën e Premte 02.11 kontaktoni **Lander Islami, Menaxher i projektit KML me email: landerislami@kosovamakers.net ose me telefon 049 729 900.**

KML Open - Raundi i Pare - 03.11.2018 - nga ora 10:00-15:00



PRISHTINA - Adresa: Fondacioni BONEVET Prishtine

kontakt: Rinë Fetahu, Tel: 044 140 443, Email: rinafetahu@bonevet.org



GJAKOVA - Adresa: Fondacioni BONEVET Gjakove

kontakt: Arber Lleshi, Tel 049 181 720, Email: arberlleshi@bonevet.org



MITROVICA- Adresa: SHMU "Musa Hoti" Mitrovice

kontakt: Lander Islami, Tel: 049 729 900, Email: landerislami@kosovamakers.net



SHTIME - Adresa:Shkolla Profesionale Shtime

kontakt: Leke Zherka, Tel: 049 814 468, Email: lekezherka@bonevet.org




KACANIK - Adresa:Shtepia e Kultures Kacanik

kontakt: Eglantine Avdiu, Tel: 049357712 Email: elgantina.avdiu@gmail.com



GARA e ROBOTIKËS "KOSOVA MAKERS LEAGUE"



KOSOVA
MAKERS
LEAGUE

KML OPEN - RAUNDI I PARË AGJENDA

[10:00 - 10:30]	REGJISTRIMI
[10:30 - 10:40]	Fjale Hyrese - Fondacioni Bonevet dhe partneret e projektit
[10:40 - 10:50]	Fotografia Kolektive
[10:50 - 11:05]	Prezentimi i stafit, jurise, rregulliat dhe menyra e vleresimit
[11:05 - 12:05]	Testimi i shtegut garues nga pjesemarresit
[12:05 - 12:30]	PAUZA
[12:30 - 14:30]	Mbajtja e Gares
[14:30 - 14:45]	Prezentimi i pikeve te arritura nga shkollat
[14:45 - 14:55]	Diskutim per piket: mundesi apeli
[14:55 - 15:00]	MBYLLJA E RAUNDIT

